



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA EKONOMIKE

(Sektori i Finances)

RELACION

MBI RAPORTIN E MONITORIMIT TE BUXHETIT TE BASHKISE DIBËR PER 12 MUJORIN 2019

Përmbajtja:

1. Buxheti i Bashkisë për Vitin 2019
2. Realizimi i te ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për 12 mujin 2019
3. Realizimi i buxhetit për 12 mujin 2019
 - Organet ekzekutive dhe legislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme
 - Ujitje e kullimi
 - Shërbimet bashkiake
 - Shërbimi i Ujesjellës kanalizime
 - Cerdhet
 - Sporti dhe shumësportet
 - Kultura dhe Turizmi
 - Arsimi parashkollor dhe 9 vjeçar
 - Arsimi I mesëm dhe konviket
 - Shërbimi zjarrfikës
 - Shërbimet Sociale
 - Fondi rezerve dhe I kontigjencës
 - QKB
 - Gjendja Civile
 - Ndihma ekonomike dhe paaftësia

Buxheti i Bashkisë për Vitin 2019

Detajimi i buxhetit për vitin 2019 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“, udhëzimin nr 9 datë 20.03.2018 ”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” udhëzimin nr 01 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2019” ,VKB nr. 03 datë04.10.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019, VKB nr 32 datë 21.03.2019 “Per miratimin e fondeve të trashëguara nga viti 2018” dhe VKB nr 34 datë 21.03.2019 Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 te Bashkisë Dibër”.

Proçesi i buxhetimit vjetor është një nga veprimtaritë më të rëndësishme të një Bashkie. Ai përcakton sa te ardhura janë mbledhur dhe sa janë shpenzuar e cila përbën planin e punës së Bashkisë. E vetmja arsye pse na duhen buxhetet është se duhet të bëjmë zgjedhje për kërkesa të ndryshme ndërsa kemi burime të kufizuara financiare. Palët përgjegjëse duhet të kenë vëmendjen tek rezultatet për të maksimizuar përdorimin eficient të burimeve të pakta. Krijimi i buxhetit është përpyetje ku përfshihen shumë vetë. Përfshin administratën bashkiake , drejtorët e organizmave bashkiake, kryetarin , këshillin bashkiak , qytetare dhe përfaqesues të bashkisë. Bërja e buxhetit është process negocimi dhe kompromisi që kulmon me miratimin nga këshilli Bashkiak. Asnjë veprim tjetër i përgatitur nga administrata, i propozuar nga Kryetari dhe i miratuar nga Këshilli Bashkiak nuk ka ndikim që ka buxheti në jetën e përditshme të qytetarëve.

Për këtë arsye për të qenë sa me transparent me të gjithë këta aktore dhe ligjërishjt jemi të detyruar të paraqesim ecurinë e punës për realizimin e buxhetit vjetor 2019.

Më poshte po paraqesim ecurinë e buxhetit për periudhën një vjecare të vitit 2019 të Bashkisë Dibër .

Realizimi i buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2019 sipas strukturave buxhetore , grupimeve e ndarjeve të kësaj strukture , në tituj e kapituj për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 jepet duke u bazuar në evidencën pasqyre 12-mujore të kuadruar me thesarin. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit sipas programeve dhe parashikimeve buxhetore, kontribuon dhe nxit ekonominë nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve publike. Në këtë kuadër, realizimi efektiv dhe në kohë i shpenzimeve buxhetore, sipas planit të dakordësuar jepet si me poshte:

Realizimi i buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2019 sipas strukturave buxhetore , grupimeve e ndarjeve të kësaj strukture , në tituj e kapituj për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 jepet duke u bazuar në evidencën pasqyrë 12-mujore të kuadruar me thesarin.

Buxheti i Bashkisë DIBËR përbëhet nga :

- Transferta e pakushtezuar
- Të ardhurat e trashëguara
- Te Ardhurat e realizuara gjatë vitit 2019
- Grantet e Kushtezuara
- Transferta Specifike
- Donacione

Buxheti i Bashkisë Dibër me vendim nr.5 datë 29.01.2019 konfirmim prefekturë nr 183/1 prot datë 07.02.2019 në total për vitin 2020 paraqitet në vlerën **810.310.136** lekë nga këto: fonde të veta të pakushtëzuara kanë qenë në vlerën **399.876.402** lekë gjithashtu janë dhe fondet e trashëguara nga viti 2018 të cilat janë mbartur në buxhetin e vitit 2019 në vlerën **14.559.391** lekë Fonde nga parashikimi i të ardhurave për vitin 2019 janë në vlerën **145.187.000** si dhe fonde të trashëguara nga të ardhurat e vitit 2018 janë në vlerën **11.056.992**. Gjithashtu me vendim të Këshillit Bashkiak nr.81 datë 26.08.2019 konfirmim prefekturë 1159/1 prot datë 29.08.2019 gjatë vitit 2019 buxhetit i është shtuar dhe një vlerë prej **2.848.000** lekë me kontribut të Word Vision për punonjësit e projektit “Tungjatjeta Jetë” si dhe me vendim Këshilli Bashkiak nr.28 datë 28.08.2019 Konfirmim prefekturë 1165/1 prot datë 28.08.2019 Qendra Balneare Peshkopi i është shtuar Buxhetit të vitit 2019 pasi ka kaluar në Varësi të Buxhetit të bashkisë Dibër me një parashikim të realizimit të të ardhurave në vlerën **20.229.450** lekë duke bërë që përmbledhësja e Buxhetit 2019 të shkojë në vlerën **833.387.586** lekë dhe shuma **227.035.571** leke (**Transferte Specifike**) fonde të trashëguara nga transferta Specifike e vitit 2018 në vlerën **12.594.780** lekë në total **239.630.351** lekë duke mos përfshirë vlerën e fondeve të deleguara (**QKR dhe Gjendja Civile**) të cilat paraqiten në vlerën prej **11.828.680** lekë.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2019 është në vlerën **83.216.604** leke ndërsa planifikimi i të ardhurave për vitin 2019 ka qenë në vlerën **145.187.000** leke. Realizimi i të ardhurave është **57.3%**.

Përdorimi nga të ardhurat e realizuara nga viti 2019 dhe të ardhurat e mbartura nga viti 2018 duke përfshirë institucionin e Bashkisë dhe institucionet e varësise si: Kultura, Shumësporti, Futbolla si dhe Qendra Balneare Peshkopi kaluar si institucion varësi nga ana e Bashkisë Dibër janë në total: **111.459.831 leke.**

Në bazë të akt-rakordimeve me thesarin për vitin 2019, totali i shpenzimeve buxhetore për paga dhe shpenzime operative është sipas strukturve të mëposhtme me vler totale **462.701.983 leke**

Ne artikullin 466 Garancite jane ne vleren **6.536.230 leke**

Likujdimet e garancise paraqiten ne vleren **14.904.813 leke**

Ne baze te akt-rakordimeve me thesarin per vitin 2019, totali i shpenzimeve buxhetore per paga dhe shpenzime operative eshte si me poshte :

Shpenzimet e pushtetit vendor perfshijne shpenzimet e kryera me te ardhurat e veta te njesive te qeverisjes vendore, si dhe nga grandet e kushtezuara dhe te pakushtezuara te qeverise. Ne kete ze shpenzimesh , perfshihen te gjitha shpenzimet e NJQV-ve, kryesisht per personelin dhe shpenzime te tjera operative te domosdoshme per ushtrimin e funksioneve te tyre . Shpenzimet e planifikuara per institucionet e Bashkise per 12 mujorin per paga jane ne vleren **416.007.998 leke** ku ne fakt jane realizuar **395.655.259 leke**, per sigurimet planifikimi eshte ne vleren **68.706.745 leke** ndersa fakti eshte ne vleren **67.046.724 leke** . Sa i perket shpenzimeve operative dhe per shpenzimet operative sipas aktrakordimeve plani eshte ne vleren **176.612.662 leke** krahasimisht me shpenzimet faktike qe jane qe jane dhe vleren **135.039.599 leke**. Gjithashtu investimet e planifikuara per vitin 2019 jane ne vleren **81.839.913 lekë**, ku ne fakt jane realizuar **64.678.955 lekë**

Po paraqesim disa nga shpenzimet operative te te gjithë strukturave ne total.

- Shpenzimet e planifikuara kancelarike jane ne vleren **2.850.000 leke** kurse shpenzimet faktike jane ne vleren **4.902.686 leke.**
- Shpenzimet e planifikuara per dru zjarri per vitin 2019 jane ne vleren **25.820.497** ndersa jane realizuar ne vleren **12.553.350 leke.**

- Ushqime te planifikuara ne total duke perfshire mallrat ushqimore, fruta perimet, prodhimet e bulmetit, mishin dhe buken jane **21.942.974 leke** ndersa te realizuarat jane ne vleren **17.143.724 leke**
- Planifikimi per shpenzimet e Energjise elektrike eshte ne vleren **6.428.330 leke** eshte likujduar likujduar per vitin 2018 **2.780.246 leke**
- Planifikimi per shpenzimet e Ujit ka qene ne vleren **3.715.972 leke** ndersa shpenzimet per faturimet e vitit 2018 jane ne vleren **4.716.136 leke**
- Planifikimi i shpenzimeve Telefonike ka qene ne vlere **861.048 leke** jane likujduar **1.492.722 leke**
- Shpenzimet e planifikuara mbi sherbimet Postes jane ne vleren **5.663.868 leke** jane likujduar **5.455.522 leke**
- Karburant eshte planifikuar **16.510.000 leke** eshte likujduar shuma **14.010.000 leke**
- Mirembajtje rrugesh planifikimi eshte ne vleren **10.947.175 leke** , shpenzime faktike jane **7.766.933 leke**
- Shlyerje vendime gjyqesore jane planifikuar **31.000.000 leke** dhe jane transferuar nga fondi rezerve **2.000.000 lekë** per arsye te sekuestroeve konservative te vendosura nga permbaruesi pra ne total **33.000.000 lekë** nga te cilat jane likujduar **32.215.365 leke**
- Paga anetar keshilli dhe Kryetar Fshatrash planifikimi ne vleren **9.064.142 leke** realizimi ne vleren **11.307.350 leke**

Ne analizen e shpenzimeve per vitin 2019 jane perfshire dhe shpenzimet nga fondi rezerve i Bashkise , nga fondi i kontigjences te cilat jane perdorur per raste te ndryshme fatkeqsishe dhe emergjenca te ndryshme . Planifikimi i fondit te emergjencave eshte ne vleren 3 % te grandit te vitit 2019 pra ne vleren 11.996.280 leke ku ne fakt vlere faktike eshte perdorur 4.759.381 leke sipas cdo emergjence me vendime te keshillit Bashkiak, te cilat paraqiten ne pasqyrenn analitike per cdo structure buxhetore sipas kategorive:

➤ Investimet e realizuara per vitin 2020 jane si me poshte :

- Rikonstruksioni I shkolles 9-vjecare Rreth-Kale ,NJA Muhurr me vlere **1.371.869** lekë
- Sistemim asfaltim Lagja Gjok Doci zona pas ish Komitetit Ekz dhe pas ish-Policise dhe zonat ku ka perfunduar rrjeti I Ujesjellesit te Ri me **vlere 1.610.405** lekë
- Sistemim asfaltim Lagja V.Dibra zona poshte shkolles 9 vjecare zonat ku ka perfunduar rrjeti I Ujesjellesit te Ri me vlere **711.744** lekë
- Rikonstruksioni I ish zyra e nd Rruga Ura Peshkopi +sistemi I ngrohjes+Rrethimi I jashtem I objektit ish zyra nd Rruga Ura Peshkopi me vlere **9.748.499** lekë
- Rikonstruksioni dhe hidroizolimi I tarraces se tregut te mishit te Bashkise Diberme vlere **1.748.499** leke
- Rikonstruksioni I varrezave publike Peshkopi,vitit 2017,bashkia Diber me vlerë **3.614.054** leke
- Rehabilitimi I sistemit ujites,Begjunec-Dobrove,Bashkia Diber,2018 me vlere **2.433.206** leke
- Punime ,mirembajtje ,ndertime rehabilitime te kanaleve ujites ne Bashkine Diber me vlere **4.800.000** lekë
- Permiresimi I infrastruktures vendore dhe rivitalizimi I hapsirave publike ne zonen prane pallatit te kultures me vlere **27.127.814** leke
- Rikonstruksion dhe mirembajtje te kanaleve vaditese te NJA Sillove,Luzni,Selishte,Kastriot,Fushe Cidhen**1.035.232** lekë
- Rehabilitimi I Rezervuarit te Shimcanit me vlerë **567.432** lekë
- Punime ,mirembajtje ,ndertime rehabilitime te kanaleve ujites ne Bashkine Diber me vlerë **2.400.000** lekë
- Rehabilitim i varezave te deshmoreve me vlerë **1.100.00** lekë
- Sistemim Asfaltim rruga Borovjan Deshat me vlerë **41.054.078** lekë
- Punime ,mirembajtje ,ndertime rehabilitime te kanaleve ujites ne Bashkine Diber me vlerë **1.762.811** lekë
- Sistemim asfaltim rruga e fshatrave Grexhdan, Pilafe, Matare e Poshtme dhe lagja Aksioni, Peshkopi (Situacion Pjesor) me vlerë **6.640.272** lekë
- Rehabilitim i varezavete deshmoreve me vlere **889.128** lekë
- Rinovim i infrastruktures se bulevardit " Elez Isufi" rruges " Safet Zhulali"(diference e palikjuduar

me vlerë **3.329.647** lekë

- Sistem asfaltim rruga e fshatrave Grezhdan, Pilafe, Majtare e poshtme dhe lagja Aksioni Peshkopi (situacion pjesor) me vlerë **6.694.682** lekë
- Majtare e poshtme dhe lagja Aksioni, Peshkopi (Situacion Pjesor) me vlere **7.074.065** lekë
- Rivitalizim lulishtesh ne lagje (f.v stola druri/betoni, rrethime metalike etj) Situacion perfundimtar dhe kontrate shtese me vlerë **554.932** lekë
- Punime, mirembajtje, ndertime rehabilitime te kanale ujitSe ne Bashkine Diber viti 2019 me vlerë **2.580.222** lekë
- Rikonstruksion i pjesshem per venien ne funksionim te kaldajes se gjimnazit " Seit Najdeni me vlere **697.333** lekë
- Rikonstruksion i Varezave Publike Viti 2017 Bashkia Diber me vlerë **612.036** lekë
- Sistemim asfaltim i lagjes Llixha-Banje Nja Peshkopi me vlere **2.100 000** lekë

Me poshte po paraqesim ne menyre analitike sipas strukturave dhe llogarive ekonomike gjendjet e fondeve te mbetura nga viti 2019

6-Viti 2019 realizimi i shpenzimeve eshte si poshte:

➤ GR .0.0. TIT 1110 (Administrata) Kap 1, 5 /leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	105.623.100	105.619.075	4.025
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	16.004.710	16.004.678	32
602 (Shpenzime operative)	45.624.207	44.888.701	735.506
606(Transferime)	700.000	699.976	24
604 (Transferime)	2.259.381	2.259.381	0
231 (Investime)	0	0	0

Totali mbartje Grand			739.587
600 (Paga) nga te ardhurat	16.638.168	16.629.424	8.744
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	2.552.454	2.552.454	0
602(Shpenzime operative nga te ardhurat)	16.400.000	16.100.617	299.383
604 (Transferime)	1.960.164	1.960.164	0
Totali mbarje nga TR			308.127

➤ **GR .0.0. TIT 10140 (Çerdhe) Kap 1, /leke**

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	15.424.164	15.166.168	257.996
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	2.575.835	2.528.696	47.139
602 (Shpenzime operative)	3.789.475	2.464.543	1.324.932
606(Transferime)	300.000	84.622	215.378
Totali mbartje			1.630.067

➤ GR .0.0. TIT 6260 (Sherbime) Kap 1,5

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	79.814.653	79.812.116	2.537
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	10.912.082	10.912.079	3
602 (Shpenzime operative)	46.063.174	41.014.723	5.048.451
606 (Transferime)	450.000	449.991	9
230 (Projekte)	90.000	0	90.000
231 (Investime)	18.549.147	17.593.778 876.531	168.838
Totali mbartje			5.309.838
600 (Paga) nga te ardhurat	11.450.000	11.409.097	40.903
601 (Sigurime shoqerore shendetsore nga te ardhurat)	5.295.061	5.096.353	198.708
602 (Shpenzime operative) nga te ardhurat	19.220.000	19.217.527	2.473
231(Investime) Nga TR	400.000	400.000	0
Totali mbartje TR			242.084

➤ GR .0.0. TIT 9240 (Konvikt) Kap 1

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	20.925.975	16.286.109	4.639.866
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	3.559.068	3.252.434	306.634
602 (Shpenzime operative)	3.789.475	2.464.543	1.324.932
606(transferte)	300.000	84.622	215.378
Totali mbartje			6.486.810

➤ GR .0.0. TIT 9120 (Arsimi) Kap 1

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	118.034.715	110.887.285	7.147.430
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	19.928.163	19.736.882	191.281
602 (Shpenzime operative)	4.077.280	3.510.733	566.547
606 (Transferime)	1.581.839	697.072	884.767
231 (Investime)	1.371.869	1.371.869	0
Totali mbartje			8.790.025

➤ **GR.0.0. TIT 9230 (Arsimi parauniversitar) Kap 1 /leke**

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	9.984.945	5.890.863	4.094.082
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore	1.568.694	1.205.583	363.111
602 (Shpenzime operative)	800.000	800.000	0
606 (Transferime)	114.000	0	114.000
Totali mbartje			4.571.193

➤ **GR .0.0. TIT 4240 (Bordi i Kullimit) Kap 1,5 /leke**

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	2.847.059	1.738.571	1.108.488
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore	475.469	290.345	185.124
606 (Transferime)	51.000	0	51.000
231 (Investime) Shlyerje Garancie	11.565.476	10.037.200 528.275	1.000.001
Totali mbartje Grand			2.344.613
231 (Investime) Te ardhura Shlyerje Garancie	6.972.094	4.763.023 250.686	1.958.385
Totali mbartje nga TR			1.958.385

➤ **GR .0.0. TIT 4260 (Sherbimi Pyjor) Kap 1**

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	6.334.068	5.733.908	600.160
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore	1.090.692	939.679	151.013
602 (Shpenzime operative)	200.000	180.000	20.000
606 (Transferime)	65.000	0	65.000
231 (Investime)	1.130.801	0	1.130.801
Totali mbartje			1.966.974

➤ **GR 0.0. TIT 3280 (Zjarrfikese) Kap 1**

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	16.412.168	16.412.102	66
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore	2.740.832	2.740.782	50
602 (Shpenzime operative)	2.347.058	2.085.378	261.680
606 (Transferime)	121.953	60.600	61.353
Totali mbartje			323.149

➤ **GR .0.0. TIT 4520 (Mirmbajtje Rruge) Kap 1**

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	12.518.983	10.070.541	2.448.442
601 (Sigurime shoqerore shendetsore)	2.003.685	1.786.759	216.926
Totali mbartje			2.665.368

➤ GR .0.0. TIT 4530 (Menaxhim rruge) Kap 1

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
231 (Investime)	26.991.916	21.594.783	4.260.566
Shlyrje Garancie		1.136.567	
Totali mbartje Grand			4.260.566
230 (Projekte) Nga TR	857.143	857.143	0
231 Investime nga Tr	2.100.000	2.000.000	0
Shlyrje Garancie		100.000	
Totali mbartjeTr			0

Fonde te deleguara te cilat nuk mbarten ne buxhetin e vitit pasardhes

➤ **GR 16 TIT 1170 (Gjendja civile) Kap 1** **/leke**

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	8.477.000	8.393.424	83.576
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	1.500.000	1.417.897	82.013
602 (Shpwnzime operative)	231.000	220.000	11.000
Totali			176.589

➤ **GR 4 TIT 4130 (QKB) Kap 10** **/leke**

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
600 (Paga)	1.315.200	1.137.680	177.520
601 (Sigurime shoqerore, shendetsore)	219.640	189.561	30.079
602 (Shpenzime operative)	85.840	70.000	15.840
Totali			223.439

Transferta per familjare dhe individe

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
606 (Transferta per familjar & individe) Ndhme ekonomike	775.180.000	414.697.496	2.519
606 (Transferta per familjar & individe) Paaftesi		360.479.985	

➤ GR 10 TIT 9240 (Kuota Ushqimore) Kap 1

/leke

Artikulli	Plan	Fakt	Diference
602 (Shpenzime operative)	2.766.750	2.123.068	643.682
606 (Trnsferime te brendshme)	102.600	0	102.600

ANALIZE E PUNES JANAR –DHJETOR 2019

ZYRA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NE BASHKINE DIBER,ne zbatim te Ligjit Nr. 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore“,Ligjit Nr. 9632 “Per Sistemin e Taksave

dhe Tarifave Vendore” I ndryshuar ,Ligjit Nr.9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe VKB Nr. 138 date 24.12.2018 “Per Miratimin e Paketës Fiskale per vitin 2019”.

PARIME, FUNKSIONE DHE OBJKTIVA TË PËRGJITHSHME

Parimet e Punës së Zyres së Taksave dhe Tarifave

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore udhëhiqet nga një sërë parimesh si:

1. Forcimi i politikës fiskale në zbatimin e drejtë të ndershëm dhe eficient të procedurave tatimore, si mjet kryesor për reduktimin e evazionit fiskal dhe krijimin e një sistemi të drejtë tatimor.
2. Nxitja e vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit të detyrimeve të taksapaguesit;
3. Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve ligjore dhe nënligjore, detyrimin e administratës së taksave për të informuar taksapaguesit, agjentët tatimorë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që disponon;
4. Zbatimi i parimeve të korrektesise, transparences, shërbimit ndaj taksapaguesit dhe trajtimit te barabarte te te gjithe taksapaguesve;
5. Hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe planeve operacionale për të garantuar zbatimin e legjislacionit tatimor në mënyrë sa më të efektshme;

Parimet e punës së Zyres së Taksave dhe Tarifave Vendore bazohen në:

- √ Transparencën
- √ Trajtimin e barabarte te taksapaguesve
- √ Llogaridhënien
- √ Bashkëpjesmarrjen me faktorët e interesit
- √ Produktivitetin e cdo veprimi që kryejmë
- √ Efektivitetin
- √ Shërbimin dhe asistencen sa më të mirë ndaj taksapaguesit

PER PERIUDHEN JANAR – DHJETOR 2019 sipas planeve dhe urdhrave te punes perkatese Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Diber ka realizuar detyrat si me meposhtme:

1. Hartimi i planit te te ardhurave per vitin 2019.
2. Rakordimet dhe vleresimet per mbylljen e vitit 2018 mbi realizimin e planit te te ardhurave.
3. Nxjerrja e listave te subjekteve debitore per vitet paraardhese dhe hedhja ne sistemin informativ.
4. Nxjerrja e subjekteve debitore per vitin 2018 dhe marja e masave sipas legjislacionit ne fuqi.
5. Evidentimi i debitoreve kryefamiljare ne territorin e Bashkise te ndare sipas njesive administrative.

6. Hedhja ne sistemin informativ e rakordimeve mujore te pagesave te taksave vendore.
7. Evidentimi i siperfaqeve te ndertesave te taksapaguesve per efekt te takses se ndertesave(nepermjet zyrave perkatese dhe inspektoreve te terrenit).
8. Paisja e dosjeve te subjekteve me dokumentin e pronesis se ose kontratat e qerases per te evidentuar dhe dokumentuar siperfaqet e ndertesave te subjekteve.
9. Mbledhja e informacioneve mbi te dhenat e subjektet ne terren dhe plotesimi I dosjeve te subjekteve me dokumentacionin e nevojshem.
10. Hedhja ne sistemin elektronik I te dhenave te mbledhura per subjektet ne terren.
11. Mbledhja e te dhenave te subjekteve ne Njesite Administrative.
12. Vleresimi dhe kontabilizimi i te dhenave te mbledhura ne terren.
13. Perpilimi i njoftim detyrimeve per vitin 2019.
14. Shperndarja e njoftim detyrimeve ne cdo subjekt(biznes I madh,I vogel,institucione,tregtare ambulante,fermere,kryefamiljare).
15. Komunikim i vazhdueshem per veprimet e ndryshme me njesite administrative.
16. Kontrolle te vazhdueshme ne terren mbi subjektin e madh dhe te vogel.
17. Aktrakordimet e pagesave mujore te subjekteve dhe nxjerrja e listes se debitoreve per kontrolle te metejshme.
18. Mbajtja e protokollit per veprimet e ndryshme ne zyren e taksave.
19. Komunikimi I vazhdueshem dhe transparent,shqyrtimi i ankesave te ndryshme nga tatimpaguesit.
20. Verifikimi I shkresave te ardhura nga Q.K.B per aplikimet e ndryshme.
21. Llogaritja e kamatvonesave te subjekteve debitore qe nuk kane paguar detyrimin ne daten e percaktuar.
22. Dergimi I urdher-blokimeve bankare per subjektet debitore.
23. Pregatitja dhe shperndarja e njoftim detyrimeve per pagesen e takses se ndikimit ne infrastructure te ardhura nga Aluizni Diber dhe te gjitha taksave vendore sipas ligjit.
24. Hedhja ne sistemin informativ dhe rakordimet per veprimet ne sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.
25. Evidentimi I subjekteve te reja nga shkresa e ardhur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.
26. Hedhja ne sistem e listes se kryefamiljareve dhe kontabilizimi I te dhenave.
27. Perpilimi dhe shperndarja e njoftimeve te detyrimit per familjaret per taksat dhe tarifat vendore ne te gjitha Bashkine Diber.
28. Komunikimi zyrtar shkresor me te gjitha institucionet sipas nevojave te punes,si dhe pergjigjia e shkresave te ardhura ne zyre.
29. Pregatitja e analizes se punes ne zyre per cdo 3 muaj.
30. Shperndarja e vertetimeve te ndryshme per subjektet sipas kerkesave.
31. E cdo detyre tjeter sipas legjislacionit ne fuqi per taksat dhe tarifat vendore.

I. ANALIZA E TE ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE PER PERIUDHEN JANAR – DHJETOR 2019

Numri i subjekteve aktivë të regjistruar pranë zyres së Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkine Diber arrin në **906 subjekte biznesi (771 biznes i vogel,76 biznes i madh,9 biznese vip,50 ambulante) 34 institucione** te cilet kryejne aktivitetin e tyre privat nen juridiksionin e Bashkise Diber dhe paguajne detyrimet vendore te cilat zene nje pjese te konsiderueshme ne planin dhe realizimin e te ardhurave vjetore.Nga keto subjekte kane paguar **661** subjekte te vogla ,68 subjekte te medha,**8** subjekte vip(hece) si dhe **31**institucione.

Në total, per periudhen **Janar – Dhjetor 2019**, te ardhurat jane realizuar ne shumen **119,400,978** leke kundrejt planifikimit **12 mujor** prej **145,187,000** leke ose **82%**.

Nga te dhenat rezulton se peshen kryesore ne te ardhurat e realizuara e zene te ardhurat nga taksat vendore kryesisht te ardhurat taksa mbi ndertesat,taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja,tarifa e pastrimit,tarifa e ndricimit,taksa e tabelës etj.

EMERTIMI I LLOJEVE TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE	PLANI I MIRATUAR 12-MUJORI(2019) 2019	REALIZIMI I TE ARDHURAVE 12-MUJORI(2019)	REALIZIMI NE %
TOTALI	145,187,000	119,400,978	82
Te ardhura Taksa Vendore	73,886,000	46,575,302	63
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	1,800,000	2,073,332	115
Takse mbi Pasurine e Paluajtshme	46,461,000	14,074,815	30
a) Takse ndertese	24,931,000	11,344,336	46
Biznese	10,427,000	8,982,008	86
Institucione+banka	608,000	357,155	59
Familje	11,190,000	1,400,800	13
Debitorët	2,706,000	604,373	22
b) Takse toke Bujqesore	20,300,000	2,267,475	11
c)takse mbi truallin	1,230,000	463,004	38
Biznese	410,000	445,362	109
Institucione	20,000	1,050	5
Familje	800,000	16,592	2
Taksa e fjetjes ne Hotel	4,000,000	513,100	13
Taks ndik infrastruktur		10,952,035	168

	6,500,000		
Taksa mbi Tras e Pasuri.Palujtshme	1,000,000	217,475	22
Taksa Vjetore e Mjeteve te Perdorura	13,000,000	17,468,345	134
Taksa per zenien e hapesires publike	200,000	524,720	262
Taksa e tabelës, reklame	925,000	751,480	81
Biznese	750,000	445,480	59
Institucione	150,000	281,000	187
Debitoret	25,000	25,000	100
Te ardhura Tarifa Vendore	64,151,000	58,071,701	91
Tarife e Pastrimit largimit te mbeturinave	24,951,000	12,415,125	50
Biznese	8,759,000	8,816,431	101
Institucione	2,600,000	1,915,000	74
Familje	10,868,000	1,310,524	12
tregtaret ambulante	150,000	18,000	12
Debitoret	2,574,000	355,170	14
Tarife e Ndricimi Rrugor	5,981,000	2,607,290	44
Biznese	1,994,000	1,869,320	94
Institucione	170,000	137,500	81
Familje	3,280,000	513,740	16
tregtaret ambulante	50,000	9,000	18
Debitoret	487,000	77,730	16
Tarife Urbanistike	1,000,000		-
Taksa e Pulles	6,000,000	3,102,604	52
Tarife Parkimi te automjeteve	850,000	781,800	92
Tarife licensimi automjeti.	1,500,000	1,261,655	84

Tarife Veterinarie.	700,000	109,900	16
Tarife ,shitja e shtypshkrimeve.	400,000	419,400	105
Tarife Gjelberimi Publik.	1,623,000	1,244,273	77
Biznese	1,244,000	1,108,710	89
Institucione	102,000	80,900	79
tregtaret ambulante	50,000	9,000	18
Debitoret	227,000	45,663	20
Kuote ushqimore Cerdhe,Kopshte.	8,500,000	6,686,060	79
Kuote ushqimore Konvikte.	3,200,000	132,210	4
Tarife e sherbimit ne Llixha.	2,000,000	28,883,364	1,444
Tarife e sherbimit ne Llixha(debitoret)	5,446,000		-
Tarife e Regjistrimit ne konvikt, Kopesht,Cerdhe	2,000,000	428,020	19
Te Ardhura Qera & Shitje Pasurie	7,150,000	7,188,682	101
Qera Truall	4,160,000	5,386,603	129
Qera Ndertese & Banese	1,700,000	1,325,027	78
Nga kullotat	900,000	-	-
Sherbime MNZ	310,000	437,000	141
Renta Minerare	80,000	40,052	50
Te tjera	-	7,565,293	-
te tjera		2,122,262	-
Te tjera te ardhura		200,000	-
te tjera gjoba		160,258	-
Te ardhura t tjera jotatimore		649,183	-
kamatvonesa		199,485	-
sponsorizime		4,198,405	-
LENDE DRUSORE		35,700	

1. Taksa mbi pasurine e paluajtshme(mbi ndertesat) planifikuar 24,931,000 leke realizuar 11,344,336 leke ose 46%.
2. Taksa per token bujqesore planifikuar 20,300,000 leke realizuar 2,267,475 leke ose 11 %.
3. Takse e fjetjes ne hotel planifikuar 4,000,000 leke realizuar 513,100 leke ose 13 %.
4. Taksa e ndikimit ne infrastructure nga ndertimet e reja planifikuar 6,500,000 leke realizimi 10,952,035 leke ose 168 %.
5. Takse hapësire publike planifikuar 200,000 leke realizuar 524,720 leke ose 262%.
6. Takse e tabelës dhe reklames planifikuar 925,000 leke realizuar 751,480 leke ose 81%.
7. Tarife pastrimi planifikuar 24,951,000 realizuar 12,415,125 leke ose 50%.
8. Tarife ndricimi planikuuar 5,981,000 leke realizuar 2,607,290 leke ose 44%.
9. Tarife parkimi per automjetet planifikuar 850,000 leke realizuar 781,800 leke ose 92%.
10. Tarife licensimi automjetesh planifikuar 1,500,000 leke realizuar 1,141,180 leke ose 91 %.
11. Tarife gjelberimi publik planifikuar 1,352,500 leke ralizuar 1,261,655 leke ose 84%.
12. Te ardhura nga qera e truallit e planifikuar 4,160,000 leke,realizimi 5,386,603 ose 129%.

Ne pasqyrat e meposhtme paraqiten rakordimet e pagesave te subjekteve te biznesit te ndara sipas kategorive dhe zonave perkatese dhe te kryefamiljareve nen juridiksionin e Bashkise Diber per periudhen e 12 mujorit Janar - Dhjetor 2019.

I. Rakordimi i pagesave te subjektit te vogel per periudhen 12 mujore Janar – Dhjetor 2019.

NR	NJ.ADMINISTRATIVE	NR TOTAL	RAKORDIMI I TE DHENAVE		TE PAGESAVE			
			PAGUAR	LEKE	%	DEBITORE	LEKE	%
1	PESHKOPI	572	513	9,890,675	90	59	1,197,835	10
2	MAQELLARE	130	107	1,323,072	82	23	271,841	18
3	MELAN	13	8	101,046	62	5	76,383	38
4	TOMIN	14	9	159,410	64	5	69028	36
5	KASTRIOT	12	10	200,325	83	2	22430	17
6	MUHUR	8	4	44,475	50	4	38,075	50
7	LUZNI	0	0	0	0		0	0
8	SELISHTE	0	0	0	0		0	0
9	ZALL-DARDHE	0	0	0	0		0	0
10	LURE	4	1	6100	25	3	23800	75
11	ARRAS	4	3	38350	75	1	9450	25
12	FUSHE-CIDHEN	6	2	21950	33	4	30,675	67
13	ZALL-REC	0	0	0	0	0	0	0
14	SLLOVE	4	2	34550	50	2	23350	50
15	KALA E DODES	4	2	21450	50	2	24350	50
	TOTALI B.DIBER	771	661	11,841,403	86	110	1,787,217	14

Gjate periudhes 12 mujore **Janar – Dhjetor 2019** jane kryer te gjitha procedurat sipas legjislacionit ne fuqi per administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve vendore per biznesin e vogel dhe sipas pasqyres se mesiperme pjesa me e madhe subjekteve rreth **86 %** ka paguar detyrimet vendore ne vleren **11,841,403 leke** per vitin 2019 ndersa rreth **14%** e subjekteve jane ne proces pagesash ne vleren **1,787,217 leke**.

Rakordimi i pagesave te subjektit te madh per periudhen 12 mujore Janar – Dhjetor 2019

NR	NJ.ADMINISTRATIVE	NR TOTAL	RAKORDIMI I TE DHENAVE		TE PAGESAVE	DEBITORE	SUBJEKTI I MADH	
			PAGUAR	LEKE	%		LEKE	%
1	PESHKOPI	50	46	4,454,381	92	4	208,244	8
2	MAQELLARE	13	11	696,168	85	2	90740	15
3	MELAN	3	3	123,448	100	0	0	0
4	TOMIN	4	4	187,280	100	0	0	0
5	KASTRIOT	2	2	104,200	100	0	0	0
6	MUHUR	3	2	43,400	67	1	28,400	33
7	LUZNI	-	0	-	0	-	-	0
8	SELISHTE	-	0	-	0	-	-	0
9	ZALL-DARDHE	-	0	-	0	-	-	0
10	LURE	-	0	-	0	-	-	0
11	ARRAS	-	0	-	0	-	-	0
12	FUSHE-CIDHEN	1	0	0	0	1	43,100	100
13	ZALL-REC	-	0	-	0	-	-	0
14	SLLOVE	-	0	-	0	-	-	0
15	KALA E DODES	-	0	-	0	-	-	0
	TOTALI B.DIBER	76	68	5,608,877	89	8	370,484	11

Gjate periudhes 12 mujore **Janar – Dhjetor 2019** jane kryer te gjitha procedurat sipas legjislacionit ne fuqi per administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve vendore per biznesin e madh dhe sipas pasqyres se mesiperme pjesa me e madhe subjekteve rreth **89%** ka paguar detyrimet vendore ne vleren **5,608,877 leke** per vitin 2019 ndersa rreth **11%** e subjekteve jane ne proces pagesash ne vleren **370,484 leke**.

Rakordimi i pagesave te subjektit Vip per periudhen 12 mujore Janar – Dhjetor 2019

NR	NJ.ADMINISTRATIVE	TE PAGESAVE						
		RAKORDIMI I TE DHENAVE				SUBJEKTI VIP		
		NR TOTAL	PAGUAR	LEKE	%	DEBITORE	LEKE	%
1	PESHKOPI	-	-	-	-	-	-	-
2	MAQELLARE	-	-	-	-	-	-	-
3	MELAN	-	-	-	-	-	-	-
4	TOMIN				-	-	-	-
5	KASTRIOT		-	-	-	-	-	-
6	MUHUR	0	0	-	-	-	-	-
7	LUZNI	0	0	-	-	-	-	-
8	SELISHTE	4	3	679,935	75	1	85,000	15
9	ZALL-DARDHE	1	1	409,348	100	0	0	0
10	LURE	3	3	2,262,105	100	0	0	0
11	ARRAS	0	0	-	-	0	0	0
12	FUSHE-CIDHEN		-	-	-	0	0	0
13	ZALL-REC	1	1	128,790	100	0	0	0
14	SLLOVE	-	-	-	-	0	0	0
15	KALA E DODES	-	-	-	-	0	0	0
	TOTALI B.DIBER	9	8	3,480,178	89	2	85,000	11

Gjate periudhes 12 mujore **Janar – Dhjetor 2019** jane kryer te gjitha procedurat sipas legjislacionit ne fuqi per administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve vendore per biznesin Vip dhe sipas pasqyres se mesiperme pjesa me e madhe subjekteve rreth **89 %** ka paguar detyrimet vendore ne vleren **3,480,178 leke** per vitin 2019 ndersa rreth **11 %** e subjekteve jane ne proces pagesash ne vleren **85,000 leke**.

Rakordimi i pagesave te Institucioneve per periudhen 12 mujore Janar – Dhjetor 2019

NR	NJ.ADMINISTRATIVE	TE PAGESAVE						
		RAKORDIMI I TE DHENAVE				INSTITUCIONE		
		NR TOTAL	PAGUAR	LEKE	%	DEBITORE	LEKE	%
1	PESHKOPI	34	31	2,772,605	91	3	374,000	9
	TOTALI B.DIBER	34	31	2,772,605	91	3	374,000	9

Gjate periudhes 12 mujore **Janar – Dhjetor 2019** jane kryer te gjitha procedurat sipas legjislacionit ne fuqi per administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve vendore per Institucionet dhe sipas pasqyres se mesiperme pjesa me e madhe institucioneve rreth **91 %** ka paguar detyrimet vendore ne vleren **2,772,605 leke** per vitin 2019 ndersa rreth **9 %** e subjekteve jane ne proces pagesash ne vleren **374,000 leke**.

Rakordimi i pagesave te familjeve per periudhen 12 mujore Janar – Dhjetor 2019

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE			
		PLANI	FAKTI	REALIZIMI %
1	PESHKOPI	12,682,000	3,457,299	27
2	MAQELLARE	10,195,000	604,120	6
3	MELAN	4,350,000	181,970	2
4	TOMIN	5,150,000	344,870	7
5	KASTRIOT	2,960,000	91,348	0
6	MUHUR	1,418,000	140,190	10
7	FUSHE-CIDHEN	1,284,000	107,275	8
8	SLLOVE	1,264,000	185,636	12
9	KALA E DODES	1,103,000	45,230	5
10	SELISHTE	1,255,000	37,380	4
11	ARRAS	1,385,000	128,203	9
12	LUZNI	1,055,000	117,810	14
13	ZALL-DARDHE	797,000	12,000	0
14	ZALL-REC	895,000	28,500	4
15	LURE	645,000	27,300	1
	TOTALI	46,438,000	5,509,131	12

DISA NGA ARSYET KRYESORE TE MOSREALIZIMIT TE PLANIT TE TE ARDHURAVE PER PERIUDHEN JANAR –DHJETOR 2019 JANE:

- Mos arkëtimi i të ardhurave nga taksa e tokes bujqesore e planifikuar ne vleren **20,300,000 leke** per 12 mujorin dhe eshte realizuar ne vleren **2,246,475 leke** ose **11%**. Per kete takse eshte planifikuar nje vlere e cila nuk realizohet as ne nivelet minimale,takse e cila ndjehet ne mosrealizimin e te ardhurave per disa arsyejje nder te cilat permendim:
 - Mungesa e dokumentacionit perkates te pronesise nga poseduesit.
 - Largimi i pronareve te tokave dhe mos perdorimi i tyre.,
 - Mungesa e vullnetit per te paguar detyrimet nga kryefamiljaret pas marrjes se njoftim vleresimeve perkatese etj.
- **Taksat dhe Tarifat Vendore te kryefamiljareve.**
Nje arsyejje tjeter e rendesishme e mosrealizimit te planit te te ardhurave eshte mos arketimi i detyrimeve te kryefamiljareve ne territorin e Bashkise Diber

Detyrimet e kryefamiljareve ndikojne drejteperdrejte ne realizimin e planit pasi eshte nje vlere e madhe per te cilat eshte e pamundur te realizohet ne nivele te larta pasi kryefamiljaret nuk kryejne pagesa vullnetare.Zyra jone ka derguar njoftim vleresimet per detyrimet vendore dhe nuk ka menyra ligjore per ti detyruar te paguajne por eshte e nevojshme nje akt marrveshje me nje agjent tatimor, shembull i ndjekur nga te gjitha bashkite.

Bashkepunimi mes institucioneve qe operojne ne territorin e Bashkise Diber nuk ka qene ne nivelin e duhur edhe pas komunikimit shkresor nga ana jone,per arketimin e ketyre detyrimeve familjare

Pergj/finance

Valdete KUCA

Drejtori Ekonomik

Lorenc CIBAKU

KRYETARI I BASHKISË

Dionis IMERAJ